



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.1636/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Telekom i Kosovës SHA me seli në Prishtinë, ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës-Drejtoria e Shëndetësisë, me seli në Mitrovicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Lirim Zeka nga Prishtina, me bazë juridike, përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës–Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, KPPP. nr.2630/22 datës 23.10.2023, me datën 25.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit Telekom i Kosovës SHA me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e shkallës së Parë, Departamenti për çështje ekonomike, KPPP nr.2630/22 i datës 23.10.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës –Dhoma e shkallës së Parë, Departamenti për çështje ekonomike me aktvendimin e ankimuar KPPP nr.2630/22 datës 23.10.2023, e ka Pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Mitrovicës-Drejtoria e Shëndetësisë, me seli në Mitrovicë, dhe ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.411/2022 datë 02.12.2022 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Ilmi Miftaraj

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës procedurale, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj këtë ankesë si të bazuar, ta prish aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e shkallës së Parë, Departamenti për çështje ekonomike, KPPP nr.2630/22 i datës 23.10.2023, dhe lënda të kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të

Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Telekom i Kosovës SHA me seli në Prishtinë, me datën 01.12.2022 ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës-Drejtoria e Shëndetësisë, me seli në Mitrovicë, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës nr191031092664, në vlerë prej 1,154.93€

Përmbartuesi Privat Ilmi Miftaraj nga Mitrovica, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.411/2022 datës 02.12.2022, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit që rrjedh nga fatura ti paguaj shumën prej 1,154.93€, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kundër aktvendimit për lejimin e përmbartimit, debitori, ka paraqitur prapësim, me pretendimin se fatura në bazë të së cilës është iniciuar procedura përmbartimore nuk është e përshtatshme për përmbartim pasi që nuk ka qenë e nënshkruar e as vulosur nga personi kompetent pranë debitorit, andaj e njëjta është në kundërshtim me nenin 27 të LPP-së, i propozon gjykatës që të aprovohet prapësimi ndërsa urdhri për lejimin e përmbartimit të anulohet.

Kreditori në përgjigje në padi ndaj prapësimit ka kundërshtuar pretendimet e debitorit si të pabazuar, duke deklaruar se debitori është njoftuar me faturat për pagesën e borxhit sepse debitori ka pranuar faturën çdo muaj nëpërmjet i-mailit. Kreditori ka kërkuar vazhdimisht që kërkesa të realizohet e kjo vërtetohet me korrespondencën e datës 06.10.2022 datës 30.08.2022, 12.08.2022, i ka propozuar gjykatës që prapësimi i ushtruar kundër urdhrin për përmbartim të refuzohet dhe urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës Parë, pas vlerësimit të prapësimit dhe shkresave tjera në lëndë, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.263/22 datës 23.10.2023, me të cilin e ka Pranuar prapësimin e debitorit, dhe ka anuluar Urdhrin për përmbartim P.nr.411/2022 i datës 02.12.2022 i lejuar nga përmbartuesi privat Ilmi Miftaraj nga Mitrovica. Në arsyetim të aktvendimit gjykata thekson se fatura nr.191031092664/2149 mbi bazën e të cilës është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm nga neni 29 par.3 i LPP-së, pasi që në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që fatura është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, duke qenë se fatura nuk përmban nënshkrimin e debitorit dhe as vulën e pranimit të shkresave të debitorit si institucion, ndërsa në shkresat e lëndës nuk gjendet ndonjë provë tjetër përmes të cilës do mund të vërtetohet se fatura është dorëzuar me rregull dhe është pranuar nga debitori.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës së lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 par.3 të LPP-së, pra janë në mospajtim me dispozitat ligjore.

Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të dhomës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Dhomat e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve, rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga dhoma e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar. Po ashtu Dhomat e shkallës së dytë vlerëson edhe Udhëzimin Administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili në nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh që: *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*.

Në rastin konkret fatura e lartcekur, nuk plotëson kushtet ligjore për tu përmbartuar sepse e njëjta nuk është e vulosur nga debitorit e as e nënshkruar nga ana e tij, ndërsa në shkresat e lëndës nuk ka prova se debitorit e ka pranuar këtë faturë, çka do të thotë se e njëjta është lëshuar njëanshëm nga ana e kreditorit. Andaj kjo gjykatë vlerëson se pretendimi i kreditorit se debitorit i janë dërguar faturat me rregull, dhe se kreditori ka ofruar shërbimet e veta debitorit sipas kushteve të Kontratës, Dhomat e shkallës së dytë, nga shkresat e lëndës vlerësoi se propozimi për përmbartim nga kreditori është iniciuar në bazë të dokumenti të besueshëm faturës 191031030192664 e cila nuk është pranuar nga debitorit dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet si dokument i vlefshëm për tu përmbartuar borxhi i kërkuar nga kreditori, ndërsa kontrata që gjendet në lëndë nuk është dokument përmbartimor në bazë të së cilës është iniciuar propozimi për përmbartim.

Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë, për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II nr.1636/23 me datë 25.03.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha